

NJOFTIMI I MODIFIKIMIT TË **KONTRATËS GJATË KOHËZGJATJES SË** **SAJ**

AUTORITETI PORTUAL DURRËS

NJOFTIMI PËR MODIFIKIMIN E MARRËVESHJES KUADËR/KONTRATËS GJATË ZBATIMIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri Autoriteti Portual Durrës
Adresa Lagja 1, Rruga Tregtare, Durrës
Tel/Faks 052293402
E-mail e.ramaliu@durresport.al
Ueb-faqe www.durresport.al

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri: E.Ramaliu
E-mail: e.ramaliu@durresport.al

3. Lloji i procedurës së prokurimit: E Hapur e Thjeshtuar – Shërbim (Me mjete elektronike)

4. Lloji i kontratës /Marrëveshjes kuader: Shërbime (Me një operator ekonomik)

5. Numri i referencës për procedurën / Lotin: NR. REF-75377-07-18-2023, duke

6. Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Marrje me qera automekanizma për nevoja operacionale” me kohëzgjatje 12 (dymbëdhjetë) muaj

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): Marrje me qera e pajisjeve lëvizëse të tokës me operator 45520000-8

8. Fondi limit:

Vlera pa TVSH – 9.705.120 (nëntë milion e shtatëqind e pesë mijë e njëqind e njëzet) lekë pa tvsh.

9. Situata sipas parashikimeve të nenit 127 të LPP dhe argumentet përkatëse për ta përdorur atë:

Me datë 14.09.2023 Autoriteti Portual Durrës ka lidhur marrëveshjen kuadër me Nr. 2673 Prot., me vlerë 9.705.120 (nëntë milion e shtatëqind e pesë mijë e njëqind e njëzet) lekë pa tvsh. dhe 11.646.144 (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e dyzet e gjashtë mijë e njëqind e dyzet e katër) lekë, me tvsh, me operatorin ekonomik ALBANIAN STEVEDORING COMPANY” (ASC) SH.P.K..

Bazuar në këtë marrëveshje kuadër Autoriteti Portual Durrës ka lidhur 3 kontrata, e fuudit me Nr. 2673/1 Prot., datë 31.11.2023, me afat 3 muaj, por jo më vonë se 5229 automjete të përpunuara.

Aktualisht ndodhemi në përfundim të afatit të saj dhe të ezaurimit të të gjithë vlerës prej 11.646.144 lekë, me tvsh të parashikuar në marrëveshjen kuadër.

Për përcaktimin e sasive për të cilat do të prokurohej shërbimi, me qëllim përlllogaritjen e fondit limit të kësaj marrëveshje kuadër janë marrë parasysh volumet e përpunuar nga Terminali i Autove përgjatë gjashtëmujorit të fundit të vitit 2022 dhe tremujorit të parë të vitit 2023. Përgjatë gjashtë mujorit të dytë të vitit 2023 është regjistruar një rritje e konsiderueshme gati në dyfishim, të volumeve mujore të përpunuara në Terminalin Auto, për shkak të rritje së kërkesës për import të automjeteve nga operatorët ekonomikë, që operojnë në tregun vendas dhe futjen ne tregun shqiptar të makinave të importuara nga Korea e Jugut.

Komisioni i pergatitjes së informacionit specifik dhe përlllogaritjen e fondit limit është në përfundim të punës për t'i përcjellë Njësisë së Prokurimit materialin specifik për zërin nr.13 të Planit të Blerjeve të Autoritetit Portual Durrës për vitin 2024, nr.72 Prot, datë 10.01.2024 me objekt "Shërbim me mjete të rënda automekanizma për Terminalin e Autove". Pas publikimit procedura e prokurimit do të kërkojë nga 30 deri në 60 ditë për përmbylljen e saj.

REKOMANDIMI:

Për sa parashtruar më sipër ndodhemi para nevojës për të garantuar vijimësinë e shërbimit të ngarkim - shkarkimit të konteinerëve pranë Terminalit Auto përgjatë kohës së nevojshme për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt "Shërbim me mjete të rënda automekanizma për Terminalin e Autove", duke konfiguruar një situatë të ngjashme me sa parashikuar në dispozitat e nenit 127 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, i ndryshuar "Mbi prokurimin publik "pika 1, shkronjat c) ku citohet:

c) kur modifikimi është bërë i nevojshëm për shkak të rrethanave të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor dhe që nuk ndryshojnë në thelb natyrën e kontratës publike apo të marrëveshjes kuadër.

Në konkluzion, në zbatim të parashikimeve ligjore mbi prokurimin publik rekomandojmë amendimin e marrëveshjes kuadër me 20% të vlerës së saj, pra në vlerën prej 1.941.024 (një milion e nëntëqind e dyzet e një mijë e njëzet e katër) lekë pa tvsh, për një periudhë prej 2 (dy) muajsh nga përfundimi i afatit të kontratës me objekt "Marrje me qera automekanizma për nevoja operationale", me Nr. 2673/1 Prot. datë 31.11.2023,

10. Përshkrimi i modifikimit të kontratës/Marrëveshjes Kuadër, përfshirë natyrën dhe sasinë ose vlerën e mallrave:

Amendimi i marrëveshjes kuadër në vlerën 20% të vlerës fillestare në shumën prej 1.941.024 (një milion e nëntëqind e dyzet e një mijë e njëzet e katër) lekë pa tvsh

Të gjitha kushtet, të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në marrëveshjen kuadër Nr. Prot. 2673 Prot., datë 14.09.2023 me objekt "Marrje me qera automekanizma për nevoja operationale", mbeten të pandryshuara dhe janë të vlefshme dhe për këtë amendament kontrate.

Ky Amendament marrëveshje kuadër bëhet pjesë integrale e marrëveshjes se sipercituar.

11. Vlera totale e kontratës së nënshkruar/marrëveshjes kuadër:

Çmimi i kontratës pa tvsh, në lekë ishte: – 9.705.120 (nëntë milion e shtatëqind e pesë mijë e njëqind e njëzet) lekë pa tvsh.

Çmimi i kontratës me tvsh, në lekë ishte - 11.646.144 (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e dyzet e gjashtë mijë e njëqind e dyzet e katër) lekë, me tvsh.

12. Vlera e ndryshuar (nëse është rasti):

Vlera pa TVSH bëhet – 11.646.144 (njëmbëdhjetë e një milion e gjashtëqind e dyzet e gjashtë mijë e njëqind e dyzet e katër) lekë pa tvsh.

Vlera me TV

SH bëhet – 13.975.372.8 (trembëdhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy presje tetë) lekë, me tvsh

13. Kohëzgjatja e kontratës / Marrëveshjes Kuadër: 12 (dymbëdhjetë muaj) nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër

Dhe afati i ri (nëse është rasti): _____

14. Emri dhe adresa e operatorit/ëve Ekonomikë:

ALBANIAN STEVEDORING COMPANY” (ASC) NIPT K92128501U

Adresa: Lagja nr.1 Rruga Tregtare, Porti Durrës, pranë zonës së Mirmbajtjes Mekanike

15. Data e nënshkrimit të modifikimit : Nr. 377/1 Prot., datë 16.02.2024

16. Burimi i financimit: Fondet e vetë institucionit

17. Informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga autoriteti kontraktor _____
